

Analizë

Projekt-ligji për Qendrën Historike të Prizrenit

Çka nuk është në rregull?

1. Në konflikt me Pakon e Ahtisaarit
 - a. Aneksi V, neni 4 mbi “zonat e mbrojtura”, paragrafi 4.1.7. e obligon komunën e Prizrenit që të themelojë zonën e veçantë për Qendrën Historike të Prizrenit
 - b. Aneksi V, neni 1 mbi “emrin, organizimin e brendshëm dhe pronën e Kishës Ortodokse Serbe”, paragrafi 1.1 thotë se të drejtat e KOS duhet të ushtrohet në pajtim me ligjet e Kosovës dhe duke i respektuar të drejtat e të tjerëve
 - c. Aneksi V, neni 5 mbi “Këshillin për Zbatim dhe Monitorim”, në paragrafin 5.3 përshkruar anëtarësinë e KZM. Katër nga shtatë anëtarë të KZM parashihet të jenë Kisha Ortodokse Serbe, Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve në Leposaviq, OSBE-ja, Këshilli i Evropës dhe UNESCO. Si mund të pritet që këto organizata të marrin pjesë në implementimin e Pakos së Ahtisaarit, e cila e bën Kosovën shtet
2. Shkelja e kushtetutës
 - a. Laiciteti – Kushtetuta e Kosovës, neni 8 e definon Kosovën shtet laik. Komiteti për Trashëgimi Kulturor do të ketë tre anëtarë nga bashkësitë fetare, duke i kamufluar ata si përfaqësues të shoqërisë civile
 - b. Neutraliteti i çështjeve fetare – Kushtetuta e Kosovës, neni 8 e definon Kosovën si neutral në çështjet e besimeve fetare. Përmes Komitetit për Trashëgimi Kulturor, bashkësitë fetare do të inkuadrohen në ushtrimin e pushtetit publik
 - i. Ligji për Lirinë Fetare – Neni 5, pika 5.2. – Bashkësitë fetare janë të ndara nga autoritetet publike
 - c. Diskriminimi - Në këtë Komitet do të jenë të përfaqësuara vetëm tri bashkësi fetare, derisa në Prizren ekzistojnë edhe komunitete tjera fetare, me ç'rast mospërfshirja e tyre është diskriminim
3. Injorimi i kuadrit ekzistues ligjor dhe institucional
 - a. Ligjet ekzistuese
 - i. Kushtetuta e Kosovës
 1. Neni 9, Trashëgimia Kulturor dhe Fetare – Republika e Kosovës siguron ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë së vet kulturore dhe fetare.
 2. Neni 58, Përgjegjësitë e Shtetit - Republika e Kosovës do të promovoj ruajtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore të të gjitha komuniteteve, si pjesë përbërëse e trashëgimisë së Kosovës. Republika e Kosovës do të ketë detyrë të posaçme për të siguruar mbrojtjen efektive të tërësisë së objekteve dhe monumenteve të rëndësisë kulturore dhe fetare për komunitetet.
 3. Neni 46, Mbrojtja e Pronës – E drejta e pronës është e garantuar
 4. Neni 38, Liria e Besimit, e Ndërgjegjes dhe e Fesë – Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, është e garantuar.
 - ii. Ligji për Trashëgiminë Kulturorë
 - iii. Ligji për Planifikim Hapësinor
 - iv. Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura
 - v. Plani Hapësinor i Kosovës
 - vi. Strategjia për Konservim të Integruar të Trashëgimisë Kulturorë
 - vii. Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit
 - b. Institucionet ekzistuese
 - i. Ministria e Kulturës – Departamenti për Trashëgimi Kulturorë
 - ii. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
 - iii. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturorë
 - iv. Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve (Instituti Rajonal Prizren)
 - v. Komuna e Prizrenit (Drejtorja për Kulturë, Drejtorja për Urbanizës, Inspektorati i Ndërtimit

4. Shkelja e standardeve ndërkombëtare të trashëgimisë kulturore
 - a. Standardet ndërkombëtare (konventat)
 - b. Praktikrat botërore të themelimit dhe menaxhimit të qendrave historike

5. Kronologji e ngjarjeve dhe procesi i mbyllur
 - a. Grupi punues në kuadër të MMPH nga viti 2009 ka punuar në fshehtësi të plotë për hartimin e projekt-ligjit
 - b. Në grupin punues ftohen vetëm nga një përfaqësues të institucioneve relevante, derisa shoqëria civile lihet jashtë
 - c. Komuna e Prizrenit ka patur vetëm një përfaqësues në këtë grup punues, Shoqëria civile ka qenë totalisht e përjashtuar nga procesi i hartimit, Nuk janë zhvilluar konsultime publike në pajtim me Rregulloren e Qeverisë
 - d. ICO aktivisht dhe publikisht avokon për nevojën për një ligj për Qendrën Historike të Prizrenit dhe i nxit institucionet shtetërore të hartojnë dhe miratojnë sa më parë këtë ligj
 - e. MMPH, pa zhvilluar konsultime publike për projekt-ligjin, e procedon atë në Kuvendin e Kosovës për miratim
 - f. Komisioni parlamentar për Planifikim Hapësinor unanimisht vendos për kthimin e projekt-ligjit në qeveri, por kjo num merret parasysh dhe projekt-ligji hyn në agjendë të seancës plenare të Kuvendit. Kuvendi i Kosovës e refuzon projekt-ligjin në lexim të parë dhe e kthen në qeveri
 - g. Qeveria, pas një jave e dërgon projekt-ligjin përsëri në Kuvend, pa ndryshuar as edhe një fjalë në përmbajtjen e tij
 - h. Komisioni parlamentar për Planifikim Hapësinor për herë të dytë, dhe përsëri unanimisht vendos për kthimin e projekt-ligjit në qeveri
 - i. Komisioni parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe Peticioni artikulon shkeljet kushtetuese të këtij projekt-ligji
 - j. Derisa projekt-ligji gjendet në shqyrtim parlamentar, MMPH tenton të improvizojë konsultime publike për projekt-ligjin

6. Ngufatja e zhvillimit ekonomik
 - a. Pjesa e zhvillimit brenda projekt-ligjit shumë e mangët
 - b. Imponohen shumë pengesa, ndalesa, burrokraci, mbindërtime institucionale, dënime dhe nuk parashihen kompensimet. Projekt-ligji më shumë kufizues se sa rregullativ.
 - c. Nuk parashihet një sistem i qëndrueshëm i menaxhimit urban për Qendrën Historike
 - d. Trashëgimia kulturore, potencial për zhvillimit ekonomik të qytetit. Projekt-ligji do të ngufasë këtë potencial

7. Rezistenca qytetare dhe shkelja e vullnetit të qytetarëve
 - a. Në vitin 2009, Forumi për Trashëgimi Kulturore i Prizrenit ka reaguar për procesin e mbyllur të hartimit të projekt-ligjit
 - b. Gjatë vitit 2010 dhe 2011 shoqëria civile e Prizrenit ka tentuar aktivisht që të hapë procesin e hartimit të projekt-ligjit
 - c. Letra dërguar institucioneve shtetërore, deklaratat publike, shkrime dhe debate nëpër media, ...
 - d. Peticioni i qytetarëve të Prizrenit për të kundërshtuar projekt-ligjin
 - e. Shoqëria civile dhe qytetarët e Prizrenit e bojkotojnë tentim-debatin e MMPH me shoqërinë civile, duke e cilësuar atë si të kundërligjshëm dhe si një përpjekje klandestine për të improvizuar procesin e konsultimeve publike për projekt-ligjin

8. Pasojat negative për shoqërinë
 - a. Ngufatja e debatit (sidomos marrë parasysh ndieshmërinë e çështjes)
 - b. Dekurajimi i qytetarisë së përgjegjshme dhe aktive
 - c. Diskriminimi në baza fetare dhe rrjedhimisht
 - d. Nxitja e urrejtjes dhe konfliktit në baza fetare
 - e. Promovimi i kulturës shtetërore që përmes ligjeve të zgjidhet të gjitha problemet

- f. Kufizimi i autonomisë lokale dhe ngufatja e demokratizimit
- g. Pengimi i zhvillimit lokal ekonomik bazuar në potencialin kulturor

Rekomandime

- Të hudhet poshtë projekt-ligji për Qendrën Historike të Prizrenit
- Të respektohen dhe të gjejnë zbatim ligjet dhe institucionet ekzistuese për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore
- Ministri i Kulturës, me kërkesë të komunës së Prizrenit, të shpallë mbrojtjen e përkohëshme të Qendrës Historike të Prizrenit
- Gjatë periudhës një vjeçare të mbrojtjes së përkohëshme, të Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve të monitorojë në mënyrë strikte respektimin e ndalesave për rrëime/ndërtime brenda zonës së Qendrës Historike
- Gjatë periudhës një vjeçare të mbrojtjes së përkohëshme, komuna e Prizrenit, në përputhje me obligimin që del nga Pakoje Ahtisaarit, të iniciojë procesin e themelimit të Qendrës Historike të Prizrenit
- Në nivel praktik, komuna e Prizrenit të themelojë një grup punues ndërsektoral, në përbërje të cilit do të jenë edhe përfaqësuesit e qeverisë qendrore dhe institucioneve tjera relevante
- Shoqëria civile e Prizrenit të jetë pjesë përbërëse e këtij grupi punues dhe të ketë numër të konsiderueshëm anëtarësh, për të siguruar përfaqësim të duhur të të gjitha grupeve të komunitetit
- Në veçanti, shoqëria civile të jetë e involvuar në procesin e themelimit të Qendrës Historike nga momenti fillestar deri në themelimin formal të saj
- Gjatë procesit të themelimit të Qendrës Historike të Prizrenit, të merren parasysh ligjet ekzistuese të Kosovës, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, për të shmangur duplikime ligjore dhe institucionale
- Ligji për Trashëgiminë Kulturore, Plani Hapësinor i Kosovës, Strategjia për Konservimin e Integruar të Trashëgimisë Kulturore (MKRS) dhe Plani i Konservimit dhe Zhvillimit për Qendrën Historike të Prizrenit (KK Prizren) të konsiderohen dokumente referencë dhe udhërrëfyes për themelimin e Qendrës Historike të Prizrenit
- Të organizohet një konferencë ndërkombëtare për të diskutuar praktikën e mira botërore të themelimit dhe menaxhimit të Qendrave Historike. Në konferencë të ftohen: menaxherë urban nga qytete evropiane, ekspertë ndërkombëtarë të trashëgimisë kulturore dhe planifikimit hapësinor, organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, institucionet shtetërore të Kosovës (qendrore dhe lokale) dhe institutet e agjencitë e specializuara (KKTK, IKMM, IKPH, IAK, etj.), ekspertë vendorë të trashëgimisë kulturore, planifikimit hapësinor, menaxhimit urban, historisë, shoqëria civile, komuniteti dhe palët e interesit
- Të organizohet konsultime publike me të gjitha grupet e komunitetit në Prizren, për të përfshirë nevojat dhe sugjerimet e tyre në formalizimin dhe menaxhimin e Qendrës Historike të Prizrenit
- Komuna e Prizrenit të hartojë Planin e Menaxhimit të Qendrës Historike të Prizrenit
- Kuvendi i Komunës së Prizrenit të miratojë një Rregullore komunale, përmes së cilës do të themelohet Qendra Historike e Prizrenit